



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-016
Prishtinë, më 30 janar 2018, në orën 10:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 30 JANAR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Sinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Albulena Haxhiu, Elmi Reçica, Sasha Milosavleviq, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu,

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Kërkesa e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për seancë të jashtëzakonshme

Kryetari e njoftoi Kryesinë e Kuvendit për gjendjen aktuale alarmante të ndotjes së ajrit në Prishtinë dhe në regjione të tjera të Kosovës, e cila kërkon ndërmarrjen e hapave nga institucionet e vendit, me qëllim që të bëhet një plan nacional nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe komunat e Republikës së Kosovës për një zgjidhje afatgjate. Ai bëri me dije se Grupi Parlamentar i PDK-së, së bashku me kolegët tjerë, iniciues të kërkesës për debat, janë duke punuar edhe në rekomandime, të cilat duhet të harmonizohen edhe me grupet tjera parlamentare.

Diskutimi i plotë i kryetarit Kadri Veseli është dhënë në transkript.

Më pas, kryetari i njoftoi të pranishmit se lidhur me këtë gjendje alarmante të ndotjes së ajrit, mbështetur edhe nga 39 deputetë të Kuvendit të Kosovës, në mbështetje të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 38.2(c) të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit më 31 janar 2018, me këtë rend dite: Debat parlamentar lidhur me ndotjen alarmante të ajrit.

Lidhur me kërkesën e parashtrua për debat parlamentare lidhur me ndotjen alarmante të ajrit diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli; Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së dhe Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia njëzëri vendosi që seanca e jashtëzakonshme të mbahet më 31 janar 2018, me fillim në orën 15:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar lidhur me ndotjen alarmante të ajrit

* * *

Të ndryshme:

Në fund, Kryesia me propozim të kryetarit të Kuvendit, z. Kadri Veseli, lidhur me Vendimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 06-V-058, datë 22. 1. 2018, për ndërprerjen e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kryesisë së Kuvendit,
Nr. 06-V-058, datë 22. 1. 2018

1. Pika 1 e Vendimit të Kryesisë së Kuvendit për ndërprerjen e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 06-V-058, datë 22. 1. 2018, ndryshohet si në vijim:

1.1. Ndërpriten të gjitha udhëtimet zyrtare jashtë vendit të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës prej datës 22 janar deri më 30 mars 2018, me përjashtim të udhëtimeve zyrtare të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, delegacioneve të përhershme pranë organizatave ndërkombëtare, për Lutjet e 66-ta të Mëngjesit, në Uashington-D.C, SHBA dhe udhëtimet zyrtare për pjesëmarrje në takime të organizuara nga institucionet e BE-së, të cilat lejohen me vendim të Kryetarit të Kuvendit, kur shpenzimet mbulohen nga organizatori si dhe me vendim Kryesisë së Kuvendit, kur shpenzimet mbulohen nga Kuvendi.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*